

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
Nr. 19624/8 i Vendimit

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 13 10. 2005, une, A. Cocco, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora ne shqyrtim kërkesen e bërë nga ana e kërkuarit, Isuf DERVISHI, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k., mbi depozitimin e vendimit të Asamblese së Jashtezakonshme të Ortakut,

KONSTATOVA SE :

Shoqëria Tregtare "Albania Tabak Fabrika e RE e Cigareve" sh.p.k. është regjistruar si person juridik në baze të vendimit Nr. 19624, datë 17. 06. 1998 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë. Ortak i vetëm është Z. Vebi Velija, i cili zoteron 100% të kuotave në kapitalin themeltar.

Kërkuari, Isuf DERVISHI, me cilësinë e administratorit të kësaj shoqërie kërkon të depozitojë vendimin e Asamblese së Jashtezakonshme të Ortakut të kësaj shoqërie të datës 10. 10. 2005, me anën e të cilit është vendosur:

- Perthithja e shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k. nga ana e Shoqërisë "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" sh.p.k.
- Rritja e kapitalit themeltar të Shoqërisë nepermjet :
 - perthithjes së shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k.
 - heqjes dore nga kerkimi i detyrimeve që Shoqëria "VEVE GROUP" sh.p.k. ka ndaj Shoqërisë.
 - nepermjet primeve të kapitalit.
- Kerkohet caktimi nga gjykata I eksperteve Luan Kamberi dhe Diana Golemi.
- Depozitimi i këtij vendimi në Regjistrin Tregtar.

Per kete qellim, shoqëria, që kërkon të perthithet "Albania Tabak" sh.p.k., e cila është e regjistruar me vendimin nr. 5926, dt. 25. 08. 1994, me anë të vendimit të ortakut të vetëm të saj, që I bashkangjitet kësaj praktike, ka dhënë miratimin për perthithjen e kësaj shoqërie.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar",

V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkeses.
2. Depozitimin e Vendimit të Asamblese së Jashtëzakonshme të Ortakut të Shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" Sh.p.k.,, datë 10. 10. 2005, me anë të të cilit është vendosur:
 - Perthithja e shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k. nga ana e Shoqërisë "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" sh.p.k
 - Rritja e kapitalit themeltar të Shoqërisë nepermjet :
 - perthithjes së shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k.
 - heqjes dore nga kerkimi i detyrimeve qe Shoqëria "VEVE GROUP" sh.p.k. ka ndaj Shoqërisë.
 - nepermjet primeve të kapitalit.
3. Caktohen ekspertet Luan Kamberi dhe Diana Golemi për për gatitjen e raportit për ktates.

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

G J Y Q T A R E

Ariana Caco

Asco